2. Dërgimin e kërkesave buxhetore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022 -2024 për Fazën Teknike të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
3. Ngarkohet Sekretariati Teknik për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Dr. Gentiana Sula

Anëtar: Altin Hoxha, Simon Mirakaj

DEKLASIFIKUAR

Plotësisht me Vendim të
KDZH Nr. 7 Datë 04 04 2017

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBH
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 12, datë 05.07.2021

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me Vendimin nr. 12, datë 05.07.2021, si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH

I. Deklasifikim i plotë i dosjeve:

- 1. Dosje nr. 278**, “Relacion i Ministrit të Punëve të Brendshme mbi veprimtarinë e organizatës armiqësore të kryesuar nga T. S., T. D. etj”, me 22 (njëzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Viti 1961.
- 2. Dosje nr. 217**, “Për disa shqetësime në Kombinatin Kimiko-Metalurgjik në Laç si dhe në Minierën e bakrit Spaç”, me 9 (nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Viti 1988.
- 3. Dosje nr. 81**, “Buletine mbi komentet dhe parrulla elementët armik rreth gjyqit të komplotistëve dhe situatës aktuale në vendin tonë”, me 43 (dyzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Viti 1961.
- 4. Dosje nr. 125**, “Informacion i Drejtorisë I-rë për komente të diplomatëve grekë për Kongresin e Lidhjes së Shkrimtarëve e Artistëve të Shqipërisë dhe marrëdhëniet e Shqipërisë me Greqinë, Italinë e Gjermaninë”, me 3 (tre) fletë. Niveli i klasifikimit është “Sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Viti 1984.
- 5. Dosje nr. 7**, “Relacion për kapjen e një diversanti dhe procesverbale të ndryshme për gjetje materiale të ndryshme të diversantëve të vdekur e të kapur”, me 9 (tre) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Viti 1953.
- 6. Fashikull nr. 2121**, në ngarkim të **H. M. dhe R. P.**, me 77 (shtatëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondit Ish Të Huajt.
- 7. Dosje formulare nr. 718/41**, në ngarkim të **Z. Ll.**, me 22 (njëzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondit Ish Të Arratisur.

8. **Fashikul nr. 336**, në ngarkim të **A. L.**, me 43 (dyzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondit Ish Të Arratisur.
9. **Dosje përpunimi nr. 2378**, në ngarkim të **P. L.**, me 43(dyzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket Ish Fondit Dega e Punëve të Brendshme Krujë.
10. **Fashikull i problemit të centralizuar “Këneta” nr. 1040**, në ngarkim të **B. K.**, me 285 (dyqind e tetëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondit Ish Dega IV.
11. **Dosje gjurmimi nr. 41**, në ngarkim të **B. K.**, me 4 volume me 714 (shtatëqind e katërbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondit Ish Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
12. **Dosje agjentrORE nr. 3738 “Kotori”**, në ngarkim të **B. K.**, me 312 (treqind e dymbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondit Ish Operativ.
13. **Dosje përpunimi nr. 2967**, në ngarkim të **A. T.**, me 2 volume me 315 (treqind e pesëmbëdhjetë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondit Ish Dega e Punëve të Brendshme Lushnje.
14. **Fashikull nr. 1503**, në ngarkim të **Sh. B.**, me 23 (njëzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondit Ish Kosova.
15. **Fashikull nr. 1647**, në ngarkim të **K. H.**, me 2 volume me 158 (njëqind e pesëdhjetë e tetë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondit Ish Drejtoria e II-të.
16. **Dosje përpunimi nr. 1394**, në ngarkim të **A. I.**, me 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondit Ish Dega e Punëve të Brendshme Fier.
17. **Dosje personale nr. 4391**, në ngarkim të **Dh. K.**, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondit Ish Operativ.
18. **Dosje formulare nr.196**, në ngarkim të **I. M.**, me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondit Ish Operativ.
19. **Dosje personale dhe pune nr. 245**, në ngarkim të **K. L.**, me 414 (katërqind e katërbëdhjetë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit ish Operativ.
20. **Fashikull nr. 4981**, në ngarkim të **T. M.**, me 28 (njëzet e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit ish Të Huajt.
21. **Dosje formulare nr. 3846**, në ngarkim të **E. M.**, me 24 (njëzet e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Ish Dega e Punëve të Brendshme Korçë.
22. **Dosje formulare nr. 9225**, në ngarkim të **S. B.**, me 26 (njëzet e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Ish Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

23. **Dosje përpunimi nr. 573**, në ngarkim të **I. K.**, me 51 (pesëdhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Ish Dega e Punëve të Brendshme Krujë.
24. **Dosje përpunimi nr. 221**, në ngarkim të **V. S.**, me 340 (treqind e dyzet) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Ish Dega e Punëve të Brendshme Berat.
25. **Dosje përpunimi nr. 4835**, në ngarkim të **M. K.**, me 208 (dyqind e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Ish Operativ.
26. **Dosje personale nr. 2170**, në ngarkim të **M. L.**, me 27(njëzet e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dosja i përket fondit Ish Operativ.
27. **Dosje përpunimi nr. 2306**, në ngarkim të **K. U.**, me 83 (tetëdhjetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Ish Dega e Punëve të Brendshme Krujë.
28. **Fashikull personal për të dënuar nr. 154**, në ngarkim të **P. K.**, me 24 (njëzet e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dosja i përket fondit Ish Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
29. **Dosje formulare nr. 1267**, në ngarkim të **P. K.**, me 3 volume, me 372 fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Ish Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
30. **Dosje formulare nr. 6020**, në ngarkim të **P. K.**, me 55 (pesëdhjetë e pesë) + 24 (njëzet e katër)fletë në zarf. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Ish Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
31. **Dosje përpunimi nr. 2452**, dhe në brendësi ka fashikull personal për të dënuar, në ngarkim të **S. D.**, me 131 (njëqind e tridhjetë e një) fletë ne total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Ish Dega e Punëve të Brendshme Fier.
32. **Dosje hetimore-gjyqësore nr. 33**, në ngarkim të **S. D.**, me 64(gjashtëdhjetë e katër) fletë ne total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Ish Dega e Punëve të Brendshme Fier.
33. **Dosje formulare nr. 9904** dhe në brendësi ka fashikull personal për të dënuar, në ngarkim të **B. D.**, me 67 (gjashtëdhjetë e shtatë)fletë ne total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Ish Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
34. **Dosje personale dhe pune nr. 2267**, në ngarkim të **H. K.**, me 3 volume, me 610 (gjashtëqind e dhjetë) fletë ne total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Ish Dega e Punëve të Brendshme Dibër.
35. **Dosje personale dhe pune nr. 2396**, në ngarkim të **A. N.**, me 2 volume, me 124 (njëqind e njëzet e katër) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Ish Dega e Punëve të Brendshme Dibër.

36. **Dosje personale dhe pune nr. 2213**, në ngarkim të **H. H.**, me 2 volume, me 63 (gjashtëdhjetë e tre) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Ish Dega e Punëve të Brendshme Dibër.
37. **Dosje personale nr. 1139**, në ngarkim të **Xh. M.**, me 48 (dyzet e tetë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Ish Dega e Punëve të Brendshme Dibër.
38. **Dosje personale dhe pune nr. 2416**, në ngarkim të **A. A.**, me 2 volume, me 205 (dyqind e pesë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Ish Dega e Punëve të Brendshme Dibër.
39. **Dosje agjenturale “Lepuri” nr. 122**, në ngarkim të **Sh. N.**, me 5 volume, me 1029 (njëmijë e njëzet e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Ish Operativ.

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 13, datë 27.08.2021

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me Vendimin nr. 13, datë 27.08.2021, si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH

II. Deklasifikim i plotë i dosjeve:

1. **Dosje objekti “Zgavra” nr. 4787**, në ngarkim të **P. C.**, me 4 volume, me 1144 (njëmijë e njëqind e dyzet e katër) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Elbasan.
2. **Dosje e problemit të centralizuar “Zgavra” nr. 1067**, në ngarkim të **P. C.**, me 3 volume, me 671 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e një) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit ish Dega IV.
3. **Dosje formulare nr. 2902**, në ngarkim të **S. Q.**, me 6 volume, me 1353 (njëmijë e treqind e pesëdhjetë e tre) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.

4. **Dosje përpunimi nr. 2422**, në ngarkim të **F. Q.**, me 6 volume, me 1557 (një mijë e pesëqind e pesëdhjetë e shtatë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.
5. **Dosje formulare nr. 2905**, në ngarkim të **Th. J.**, me 4 volume, me 636 (gjatëqind e tridhjetë e gjashtë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.
6. **Dosje hetimore nr. 29**, me 20 (njëzet) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1988. Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Kukës.
7. **Regjistër agjenture Nr. 1**, Model 2, me 197 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë) fletë, fillon me nr. rendor 26 dhe mbaron me numrin rendor 5422, në total janë 53 (pesëdhjetë e tre) fletë të plotësuar. Niveli i klasifikimit të regjistrit është “Sekret”. Regjistri i përket fondit Ish Dega e Punëve të Brendshme Dibër.
8. **Dosje personale dhe pune nr. 4874**, në ngarkim të **D. M.**, me 157 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondit Ish Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.
9. **Fotokopje kartelë model 2, nr. 2226**, në ngarkim të **D. M.**, me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit është “Sekret A.R.P.”. Kartela i përket fondit Ish Dega IV.
10. **Fondi 4, Drejtoria I, Dosje nr. 363, viti 1985**. Urdhër i Ministrisë së Punëve të Brendshme drejtuar repartit 313 për trajtimin me ushqim special të të arrestuarve, I. H., S. B., Sh. Ç., A. P. etj. Dosja ka 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.
11. **Fashikull i problemit të centralizuar nr. 1080 “Debiti”**, në ngarkim të **A. J.**, me 2 volume me 334 (treqind e tridhjetë e katër) fletë në total + 2 (dy) fletë në zarf. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondit Ish Dega IV.
12. **Dosje formulare nr. 274**, në ngarkim të **A. J.**, me 3 volume me 98 (nëntëdhjetë e tetë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondit Ish Dega IV (Fondi rezervë).

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula



**VEPRIMTARI TË AUTORITETIT
PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT
TË SHITETIT PËR PERIUDHËN
KORRIK – GUSHT**

VEPRIMTARI TË AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET

E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT PËR PERIUdhËN KORRIK – GUSHT

Të pagjeturit e zonës së bregut dhe asaj kufitare në jug të vendit

Më 7 dhe 8 korrik, ekipi i AIDSSH zhvilloi një udhëtim njohës e përkujtimor, si dhe takime prezantuese në zonën e bregut dhe të Sarandës, në kuadër të projektit të ICMP-AIDSSH “Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzitore dhe pajtuese: adresimi i çështjes së personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste”, i mbështetur nga Bashkimi Europian.

Fillimisht, ekipi i Autoritetit vizitoi kalanë e Porto-Palermos, vend ndëshkimi gjatë regjimit komunist për të dënuar të ndërgjegjes.

E vendosur në gadishullin që sot mban emrin Porto-Palermo, kalaja që i atribuohet Ali Pashë Tepelenës mendohet të jetë shumë më e vjetër se fundi i shekullit XVIII, kur u përshtat për sfida luftarake të



kohës.

E përdorur si vend internimi nga italianët, në 1948, me vendosjen e regjimit komunist në vend, kalaja mori statusin e monumentit të kulturës. Edhe si e tillë, për një periudhë të shkurtër, 1949-1950, kalaja u përdor si vend internimi i burrave, grave e fëmijëve, familjarë të kundërshtarëve politikë, të cilët mbaheshin të izoluar, në kushte të vështira në mjediset e saj të errëta e pa dritë. Shumë të dënuar të kampit të Tepelenës ndaluan për disa kohë në Porto Palermo, mes tyre edhe Lek Pervizi, që me vizatimet e tij akribike dëshmoi vendet e internimit në jug të

vendit. Dëshmi të të mbijetuarve të Porto-Palermos janë publikuar sot në libra të kujtesës.

Sot monument kulture, e vizitueshme nga shqiptarë e të huaj, kalaja dëshmon shumë histori, mes të cilave ato të diktaturës, duke mbartur edhe gjurmën e tyre në të sotmen.

Njohja në terren e vendeve të kujtesës, ku u shkrua historia e shtypjes dhe mbijetesës, e mbështetur në “luftën e klasave”, përcakton itinerare të vizitueshme nga të rinjtë e shkollarët, për njohjen me vendet e vuajtjes së dënimit dhe ndëshkimit.

Pas kalasë së Porto Palermos, ekipi ndaloi në fshatin Shën Vasil, dikur i quajtur Përparim, ku pas mesit të viteve '80 u sollën edhe të dënuar të ndërgjegjes.

Në dalje të fshatit, pranë varrezave të banorëve, pas murit rrethues, prehen ende ish-të burgosur të cilët kërkohen nga familjarët, që kanë aplikuar pranë institucioneve shqiptare për zhvarrimin dhe identifikimin e të afërmeve të tyre.

Edhe pas 30 vitesh, familjarët e të burgosurve që ndërruan jetë në ish-burgun Përparimi dhe u varrosën pranë varrezave të fshatit, nuk kanë marrë mbetjet njerëzore të të afërmeve të tyre. Aplikimet dhe kërkesat pranë institucioneve synojnë finalizimin e këtij procesi, sipas protokolleve ndërkombëtare.

Vizitat në terren i paraprinë aktivitetit të radhës për të zhdukurit në komunizëm që AIDSSH organizoi në bashkëpunim me ICMP dhe pushtetin lokal në Sarandë, më 8 korrik, në bashkinë e qytetit.

Më 8 korrik, në mjediset e bashkisë së Sarandës u prezantua udhëzuesi për familjarët e të zhdukurve në komunizëm, në prani të familjarëve të të pagjeturve të komunizmit në zonën e bregut, asaj kufitare dhe në Sarandë, shoqatave të të përndjekurve dhe kujtesës, përfaqësuesve të grupeve të interesit,



aktorëve të shoqërisë civile dhe gazetarëve.

Njëkohësisht, Autoriteti prezantoi për qytetarët sarandiotë ekspozitën “E shkuara e pakryer”, me profile të të pagjeturve të komunizmit, dëshmi të mbledhura nga familjarë të të pagjeturve në kuadër të projektit dhe materiale të përzgjedhura nga hulumtimi në historikët e Sigurimit.

Udhërrëfyesi për familjarët e të zhdukurve në komunizëm u prezantua nga z. Skënder Vrioni, në komunikim publik me të interesuarit, para finalizimit të tij dhe shpërndarjes, duke bërë të qarta pikërisht funksionet e institucioneve në proces dhe hapat që duhet të ndjekin familjarët.

Sipas znj. Gentiana Sula, kryetare e Autoritetit, “është e rëndësishme që të gjithë aktorët të bëhen bashkë, që familjet dhe institucionet të dëgjojnë njëri-tjetrin dhe të kenë mundësi të bashkëpunojnë për t’i dhënë zgjidhje kësaj çështjeje, që është përgjegjësi e shoqërisë së sotme shqiptare”.

Nënkryetarët e bashkive të Sarandës dhe Himarës, znj. Lindita Qendro dhe z. Pervin Gjokuria përgëzuan për nismën dhe premtuan mbështetje të bashkive përkatëse përsa u takon proceseve që lidhen me të zhdukurit dhe mostjetërsimin e vendeve të raportuara.

Përfaqësuesi i bashkisë Konispol, z. Vangjel Taho, në vijim të bashkëpunimeve të kësaj bashkie me Autoritetin, foli mbi gatishmërinë e bashkisë Konispol për të mbështetur nismat mbi të zhdukurit dhe punën me ta.



Të pranishëm në takim, prokurori i Sarandës, z. Ilir Hoxha dhe shefi i komisarariatit Sarandë z. Syrja Bellaj u shprehën në emër të institucioneve përkatëse që do të bashkëveprojnë në marrëveshje me Autoritetin, për një proces të koordinuar e të kujdesshëm, në përgjigje të aplikimeve dhe kërkesave të familjarëve që po ndërmarrin hapa konkretë.

Takimi u moderua nga Ardita Repishti e AIDSSH dhe vijoi me qëndrimet e shoqatës së ish-të përndjekurve politikë të Sarandës, z. Llambro Nesturi e të tjerë, të gazetarëve të zonës, që në vite u kanë dhënë zë këtyre historive, mes të cilëve z. Thoma Nika, dhe të interesuarve të drejtpërdrejtë, që bënë propozime dhe hodhën ide për trajtimin e

çështjeve. Gjatë bisedës u shpërndanë draftudhëzues për të pranishmit dhe u plotësuan formularë nga familjarët e të zhdukurve.

Në mbyllje të takimit, u regjistruan dëshmi për të pagjeturit e Sarandës, nga familjarët e tyre.

Dialogu për Tiranën

Dialogu për Tiranën vijoi në Autoritet në takimin e kryetares Sula me nënkryetarin e Bashkisë Tiranë, z. Andi Seferi, dhe kryetarin e Shoqatës Tirana, z. Arben Tafaj.



Faza e parë e projektit që hedh dritë në dokumente arkivore të Sigurimit të Shtetit dhe veprimtarisë së tij në Tiranë pritet të realizohet muajt e ardhshëm të 2021. Projekti do të ketë bazë të gjerë dhe mbështetet në bashkëpunimin e ngushtë me komunitetin, historianët, institucionet dhe pushtetin lokal.

Të pagjeturit në Tepelenë

23 gusht, Dita Europiane e Viktimave të Totalitarizmit

Më 23 gusht, Ditën Europiane të Viktimave të Totalitarizmit, ekipi i Autoritetit zhvilloi sot pelegrinazhin e përvitshëm në ish-kampin e internimit të Tepelenë, vend ndëshkimi gjatë regjimit komunist, 1949-1953.

Kampi me tela me gjemba i Tepelenës është një nga faqet e errëta të diktaturës, ku u mbajtën për disa vjet në kushte cnjerëzore me mijëra familjarë të kundërshtarëve të regjimit, gra, fëmijë e të moshura, të pafajshëm. Mes tyre edhe Lek Pervizi, sot në të nëntëdhjetat, që me vizatimet e tij akribike dëshmoi këtë kamp internimi, historitë e tij, madje edhe një hartë me vendvarrimet e atyre që mbetën në Tepelenë. Dëshmitë flasin për qindra jetë të humbura, që ende sot kërkohen nga familjarët.



Sot, ish-kampi i internimit i Tepelenës pritet të kthehet në muze, i vizitueshëm nga shqiptarë e të huaj, duke dëshmuar diktaturën dhe gjurmën e saj në të sotmen.



Njohja në terren e vendeve të rëndësishme të kujtesës përcakton edhe itinerare të vizitueshme nga të rinj e shkollarë, për njohjen me vendet e vuajtjes së dënimit dhe ndëshkimit në komunizëm. Pas vizitës përkujtimore në kamp, me të mbijetuar e trashëgimtarë të tyre, përfaqësues të shoqatave të drejtave të njeriut, takimi vijon në pallatin e kulturës Tepelenë, me aktivitetin e radhës për të zhdukurit, që AIDSSH organizon në bashkëpunim me ICMP dhe pushtetin lokal në Tepelenë, në kuadër të projektit “Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzitore dhe pajtuese: adresimi i çështjes së personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste”, i mbështetur nga Bashkimi Europian.

Autoriteti prezantoi për qytetarët e Tepelenës ekspozitën “E shkuara e pakryer”, me profile të të pagjeturve të komunizmit, dëshmi të mbledhura nga familjarë të të pagjeturve në kuadër të projektit dhe materiale të përzgjedhura nga hulumtimi në historikët e Sigurimit.



Udhërrëfyesi për familjarët e të zhdukurve në komunizëm u prezantua nga znj. Mirela Lame, në komunikim publik me të interesuarit, duke bërë të qarta funksionet e institucioneve të përfshira dhe hapat që duhet të ndjekin familjarët.

Kryetari i bashkisë Tepelenë, z. Tërmet Peçi dhe nënkryetare e bashkisë Gjirokastrë, znj. Jorida Muho, premtuan mbështetje të bashkive përkatëse përsa u takon proceseve që lidhen me të zhdukurit, ku pushteti lokal luan rolin e vet, dhe mostjetërsimin e vendeve të raportuara.

Të pranishëm, kryeprokurori i Gjirokastrës, z. Julian Cafka dhe shefi i komisariatit Tepelenë, z. Roland Zhapa, u shprehën në emër të institucioneve përkatëse që do të bashkëveprojnë në marrëveshje me Autoritetin, për një proces të koordinuar e të kujdesshëm, në përgjigje të aplikimeve dhe kërkesave të familjarëve.

Po ashtu, përfaqësues të komuniteteve fetare, Sheh Hysen Hormova dhe z. Orfea Beci, i Mitropolisë Gjirokastrë, ngritën zërin për të pagjeturit e zonës, të dënuar apo ekzekutuar gjatë diktaturës, duke kërkuar veprim të institucioneve të pranishme.

Në takime u shpërndanë udhëzues dhe u plotësuan formularë nga familjarët e të zhdukurve. Në mbyllje u regjistruan dëshmi nga të mbijetuarit e Tepelenës.

Hapat i radhës në Tepelenë e Gjirokastrë do të jenë në terren, në vendvarrimet e raportuara, për veprim konkret e të koordinuar të institucioneve.

Prezantohet ekspozita “Sigurimi në fjalët e veta” për të zhdukurit në diktaturë

Ekspozita “Sigurimi në fjalët e veta” u zhvillua më 30 gusht, në Ditën Ndërkombëtare të të Zhdukurve, me praninë e Kryeministrit, z. Edi Rama, grupeve të interesit, familjarëve të të pagjeturve, institucioneve publike qendrore dhe vendore, komuniteteve fetare, përfaqësuesve të trupit diplomatik, organizatave ndërkombëtare, shoqërisë civile, shoqatave të të drejtave të njeriut, studiuesve, gazetarëve e studentëve.

The poster features a background of colorful, concentric fingerprint patterns. On the right side, the text reads: **19 DEGË SIGURIMI**, **3299 JETË***, and **1 HISTORI**. On the left side, it says: **LULISHTJA "FADIL KOKOMANI", PRANË KRYEMINISTRISË** and **30 GUSHT 2021 - 18.00**. At the bottom, there are logos for the International Commission on Missing Persons (icmp), the European Union, the Swiss Confederation (Schweizerische Eidgenossenschaft / Confédération suisse / Confederazione Svizzera / Confederaziun svizra), and the Albanian Information Security Authority (Ambasata e Zvicrës në Shqipëri / AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHQITËT). A small note at the bottom states: *Numri i personave të zhdukur nuk është përfundimtar dhe ndryshon në sajë të gjetjeve dhe verifikimeve.

Prezantimi është i pari i këtij niveli dhe i jep akses publikut e të interesuarve në dokumentacion e të dhëna deri më sot të panjohura, duke përmbushur misionin e Autoritetit për informim dhe transparencë, në zbatim të ligjit 45/2015 i ndryshuar.

Ekspozita për të zhdukurit, me materiale të ish-Sigurimit të Shtetit u zhvillua në kuadër të projektit “Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzicionale dhe të pajtimit: të zhdukurit të komunizëm” të ICMP-AIDSSH, të mbështetur nga BE dhe Ambasada Zvicerane dhe do të qëndrojë e hapur deri më 3 shtator 2021.

Mbajtën fjalën në ceremoni, kryetarja e Autoritetit, znj. Gentiana Sula, z. Matthew Holliday, Shef i Programit, Ballkani Perëndimor, Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur, z. Alexis Hupin, I ngarkuar me punë BE në Shqipëri, z. Ylber Merdani, i shoqatës së të përndjekurve politikë, Korçë, dhe z. Edi Rama, Kryeministri i Shqipërisë.



NJOHJA NXIT STUDIMIN 🍌

Fati i revistave kulturore “reaksionare” pas vendosjes së diktaturës në Shqipëri

PROFILE TË “ARMIKUT TË POPULLIT” NË DIKTATURË



KONFERENCË NDERKOMBËTARE SHKENCORE

📄 🍌 *Studimi u përgatit nga Ma. Alma Mile, në kuadër të konferencës ndërkombëtare shkencore të AIDSSH me ASA, ISKPK, IIPP, “Fytyra e “Armikut” të popullit”.*

📄
“Neve nuk na mbetet një gjë për të bërë: Të botojmë revista! Të botojmë revista dhe të punojmë me mend, me system dhe me seriozitet. Të lemë mendjen t’onë të çliruar dhe t’emancipuar ndër idera të realitetit shoqëror shqiptar, të udhëtojë lirisht, por me ngadalë dhe me kujdes nëpër gërmadhat e jetës sonë brenda të cilave flen qysh prej shekujsh...”.

Branko Merxhani (Revista: Përpyekja Shqiptare).

Përgjatë afro një dekade gjalluan disa nga revistat më të rëndësishme në historinë e shtypit shqiptar, ku shkruan penat më të rëndësishme të kohës, poetë, shkrimtarë, përkthyes, filozofë e ideologë, të cilët ofruan një dritare kulture në Shqipërinë e prapambetur e analfabete të gjysmës së parë të shek. XX. “Hylli i Dritës”, “LEKA”, “Përpyekja shqiptare”, “Illyria”, “Shkëndija”, “Kritika”, “Revista letrare”, “Minerva”, etj., janë disa nga revistat, të cilat mbledhën rreth vetes personalitete si At Gjergj Fishta, Ernest Koliqi, Branko Merxhani, At Anton Harapi, Lasgush Poradeci, Nebil Çika, Nexhat Hakiu, Mitrush Kuteli, Arshi Pipa, Vedat Kokona, Migjeni, Ali Asllani, Vangjel Koça, Tajar Zavalani, etj.

Në faqet e këtyre revistave u botua folklor, poezi, prozë të autorëve shqiptarë e kryevepra të letërsisë botërore, filozofi, ndërsa mori jetë debati mbi letërsinë dhe kritikën letrare.

Pas instalimit të diktaturës komuniste, ato, jo vetëm u mbyllën, por emri dhe kontributi i tyre u fshi nga tekstet dhe historitë e letërsisë shqipe apo historisë së mendimit shqiptar, edhe pse ishin një hallkë e rëndësishme në këtë zinxhir zhvillimi.

Ato u konsideruan “vegla të shtresave reaksionare”.

Fati i tyre u lidh ngushtësisht me fatin e drejtuesve dhe autorëve që shkruan në to. U shpallën “armiq të popullit”, u dënuan në mungesë, u dënuan me burg, u pushkatuan ose u lanë në harresë. Vepra e Fishtës u mohua pas vdekjes; Ernest Koliqi e Arshi Pipa u larguan nga vendi për të mos u kthyer më, ndërsa vepra e tyre u ndalua; At Anton Harapi u pushkatua, Vinçenc Prennushi vdiq në burg, Aleksandër Sirdani vdiq nën torturë; Mitrush Kuteli, Nexhat Hakiu, Vedat Kokona u lanë në hije....

PROFILE TË
“ARMIKUT TË POPULLIT”
NË DIKTATURË



KONFERENCË NDERKOMBËTARE SHKENCORE

Revolucioni permanent: Figura e “armikut të klasës” në letërsinë e realizmit socialist në Shqipëri

📖👉 Studimi u përgatit nga Dr. Anjeza Xhaferaj, në kuadër të konferencës ndërkombëtare shkencore të AIDSSH me ASA, ISKPK, IIPP, Muzeun Historik Kombëtar, “Fytyra e “Armikut” të popullit”.

Praktika e prodhimit të armiqve gjeti vendin e saj edhe në art. Letërsia, si mjet efikas që në letërsinë e realizmit socialist synonte të pasqyronte të ashtuquajturin “realitet socialist”, nuk i shpëtoi dot ndikimit të direktivave që vinin prej udhëheqjes.

Ajo përvetësoi fjalorin e partisë dhe arriti të krijonte me “sukses” prototipin e armikut që mund të gjendej kudo, si te të deklasuarit, ashtu edhe në gjirin e klasës punëtore apo edhe në vetë gjirin e Partisë.

Që në fillimet e tij, regjimi komunist shqiptar synoi ta vendoste letërsinë në kontroll të plotë, në mënyrë që të kontrollonte dhe dijen që kjo letërsi prodhonte. Përmes letërsisë, regjimi komunist synoi të ndërtonte një

situatë revolucioni permanent, ku armiku gjithmonë prezent, edhe pse zbulohet dhe eliminohet prej Partisë vigjilente, sërish arrinte të mbijetonte për të justifikuar valët e herëpashërëshme të likuidimit në radhët e elitave drejtuese të Partisë së Punës.

Kjo sigurisht kërkonte praninë dhe pranimin e vëzhgimit dhe raportimit të çdo të dyshuari që mund të prishte lumturinë e ndërtimit të socializmit. Përmes letërsisë dhe artit në përgjithësi, shteti totalitar shpiku dhe eliminoi armiq dhe në këtë mënyrë legjitimoi ashpërsinë e regjimit, kontrollin e plotë në fushën e politikës, ekonomisë, artit e rendit, si dhe izolimin e vendit...

Përjashtimi nga historia e letërsisë, si dënim për shkrimtarët “armiq”

(Si u trajtuan Fishta, Konica e Koliqi; vështrim krahasimor mes dy teksteve të botuara nga Akademia e Shkencave dhe një boceti)

PROFILE TË
“ARMIKUT TË POPULLIT”
NË DIKTATURË



KONFERENCË NDERKOMBËTARE SHKENCORE

📖👉 Studimi u përgatit nga Ma. Brunilda Prifti, në kuadër të konferencës ndërkombëtare shkencore të AIDSSH me ASA, ISKPK, IIPP, Muzeun Historik Kombëtar, “Fytyra e “Armikut” të popullit”.

Tekstet e historive të letërsisë shqipe janë pasqyra më e mirë e dënimit me përjashtim të një numri jo të paktë shkrimtarësh e poetësh, të shpallur si “armiq të popullit”, jo për shkak të veprës së tyre letrare, por për shkak të angazhimit të tyre politik.

Ky përjashtim nga tekstet e historisë së letërsisë ka shërbyer si dënim prapavajtës për një grup autorësh, vepra letrare e të cilëve është


krijuar përpara vendosjes së regjimit komunist dhe kanonizimit të realizmit socialist në letërsi e arte. Raste tipike të këtij lloj dënimi i gjejmë në përjashtimin e veprës së Gjergj Fishtës, Faik Konicës e Ernest Koliqit, fshirja e të cilëve, ku plotësisht e ku cekur përciptaz, aq sa meritonin të lakoheshin armiqtë, solli dëm të tejskajshëm në hierarkinë letrare.

Dy të parët nuk jetuan aq sa ta merrnin për së gjalli këtë dënim, ndërsa Koliqi e ka vuajtur shumë këtë ndërprerje komunikimi me lexuesin e tij shqiptar, që nga Roma, ku jetoi deri sa vdiq, me damkën e “fashistit” dhe “armikut të popullit”. Historia e letërsisë shqipe në rrugëtimin e saj, fill pas ndryshimeve

që pasuan në vitet '44-'45 e deri në botimin e 1983-shit, nuk mundi dot t'i shkiste kufizimeve ideologjike, as kufirit të vënë: "me ne, ose kundër nesh".

Mjaft të kujtojmë deklaratën e Shefqet Musarajt gjatë fjalës në Konferencën III të Lidhjes së Shkrimtarëve, në tetor 1949, për të kuptuar drejtimin që do të merrte letërsia, edhe pse sinjalet ishin dhënë së paku 3 vite më parë: "Po mundet që në mes t'onë të ketë shkrimtarë që të mos jenë për këtë udhë. Ne jemi të detyruar t'u shpjegojmë këtyre udhën e drejtë. Në qoftë se me gjithë përpjekjen t'onë, s'do mund të kuptojnë ose do të bëjnë sikur s'kuptojnë...të jenë të sigurt se puna ose lufta jonë do t'i eliminojë"...

Armiqtë e vërtetë të popullit

 Studimi u përgatit nga Çelo Hoxha, në kuadër të konferencës ndërkombëtare shkencore të AIDSSH me ASA, ISKPK, IIPP, Muzeun Historik Kombëtar, "Fytyra e "Armikut" të popullit".

PROFILE TË "ARMIKUT TË POPULLIT" NË DIKTATURË



KONFERENCË NDËRKOMBËTARE SHKENCORE

Koncepti i armikut të popullit u përdor nga komunistët që gjatë luftës, si një masë ligjore ndaj personave të caktuar, në përgjithësi kundërshtarë politikë të tyre. Pas lufte, kundërshtarët e regjimit dënoheshin bazuar në dy nene të ligjit për gjykatat ushtarake (14 janar 1945):

neni 14, krimineli i luftës dhe neni 15, armiku i popullit.

Neni 15 ishte një përkufizim për armikun e popullit në këndvështrimin e regjimit komunist, i cili përfshinte kategori të ndryshme njerëzish, jo domosdoshmërisht politikanë. Armiq të popullit u etiketuan dhe njerëz që thjesht ishin pro ekonomisë private për arsye krejt personale, ose persona që kishin lidhje gjaku me kundërshtarët realë ose të supozuar të regjimit, etj.

Duke përdorur të njëjtat përkufizime që përdorën komunistët, ky studim përpiqet të argumentojë se armiqtë realë të popullit gjendeshin në anën e strukturave që dënuan me mijëra persona si armiq të popullit...